



Grimca për Shoqërinë Civile

Fondet Publike për
OJQ në vitin 2024




Shumë prej përvojave që i marrim si të mirëqena, nga trajnimet falas për të rinj, ecje grupe të pensionistëve nëpër natyrë, ekspozita arti, apo aksione qytetare, realizohen nga OJQ-të me mbështetje nga fondet publike.



Kosova ndau 13.34* mil. € grante për 1,413 projekte nga OJQ-të në 2024

Financuesit më të mëdhenj të OJQ-ve (2024):



*Shuma prej 13.34 mil. € dhe 1,413 projekte përfshinë mbështetjen e dhënë nga institucionet qendrore dhe komunat

**Shifër e nxjerrë nga të dhënat publike në uebfaqen e MKRS-së. Raportimi final në platformë ka pasur mangësi.

***Kjo shifër mund të ndryshojë sepse ka pasur mangësi në raportim të fondeve të ndara për OJQ.

Nga 13.34 mil. € grante, vetëm 8.2 mil. € dedikohen për projekte të OJQ-ve.

**2.3 mil. €
(17%)**

Grante për
financimin e sportit,
kryesisht në nivel
lokal.

**2.8 mil. €
(21%)**

Kontraktimi i
shërbimeve sociale që
nuk i ofron shteti, të mbuluara
nga OJQ-të.


**8.2 mil. €
(62%)**

Grante për
projekte të OJQ-ve.



Çfarë mbështetet përmes granteve për projekte të OJQ-ve?

Nëse thellohem në projektet e OJQ-ve në nivel qendror në 2024, **pjesa dërmuese e financimit shkoi për kulturën dhe artin.**




Fondet për OJQ-të janë të vogla dhe afatshkurta

Mesatarisht, shteti ndanë grante prej vetëm 5,000 € për projekte që zgjasin më pak se 12 muaj.

7,600 €

Mesatarja e granteve në nivel QENDROR.




3,500 €

Mesatarja e granteve në nivel LOKAL.


Mbështetja afatgjatë është e mundur

MKRS zgjodhi rrugë tjetër në 2024. Përmes thirrjes për Art, Kulturë dhe Trashëgimi ofroi mbështetje për projekte trevjeçare, krahas atyre më pak se një vit.

15 organizata të pavarura kulturore u mbështetën me mesatarisht 68,000 € në vit për zbatim të programeve të tyre, shembull i politikës publike me vizion afatgjatë.



Fonde pa planifikim dhe vizion



80%

të thirrjeve publike nga
institucionet qendrore NUK
janë referuar në dokumente
programore apo strategjike.

55%

të institucioneve qendrore
NUK e kanë kryer ndonjë
formë konsultimi me OJQ-të
para se të shpallin thirrjet.

Shteti nuk ka pasqyrë të qartë rreth fondeve që ndanë.

Platforma online për mbështetjen publike financiare për OJQ-të, që duhet të raportojë shpenzimet publike për OJQ-të, çdo vit ka pasaktësi dhe mungesë standardesh raportimi.

PLATFORMA ONLINE PËR MBËSHTETJEN
PUBLIKE FINANCIARE PËR OJQ-TË

OJQFINANCIME.RKS-GOV.NET

JOFUNKSIONALE*


12 komuna

nuk kanë raportuar në platformë ndonëse hapën thirrje dhe publikuan lista përfituesish.

5 mil. €

të raportuara më pak nga niveli qendror për shkak të problemeve teknike.

*QË NGA GUSHTI 2025.



Mbështetja publike për OJQ-të duhet të shihet si investim afatgjatë në të mirën e përbashkët, një premtim për të ardhmen e qytetarëve, dhe jo thjeshtë si shpenzim teknik dhe i përkohshëm.

